



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL.Anr. 636/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, Kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Bardhyl Sopjani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik AKR, me seli në Prishtinë, dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Bardhyl Sopjani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik AKR me seli në Prishtinë, dega në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.636/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017 në ora 12:45, nga Bardhyl Sopjani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik AKR me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në shkollën fillore “Shkëndija” e njëjta Qendër e Votimit 1927E/04R në Hajvali, në shkollën fillore “Ganimete Tërbeshi” e njëjta qendër e votimit 1940E në Llukarë, në të gjitha kutit e votimit PZAP-it i ka kërkuar që të rinumëroj votat, sepse të afërmit e mij familjarë kanë votuar në pikat e votimit të lartëcekura.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në shkollën fillore “Shkëndija, e njëjta qendër e votimeve 1927E/04R në

Hajvali, në shkollën fillore “Ganimete Tërbeshi” e njëjta qendër e votimit 1940E në Llukarë , si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar krahasimin e votave lidhur me mungesën e votave, sipas pretendimeve ankimore e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**

Anr.636/2017 më datën 10.11.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltene Sylejmani

***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*